



Bordi

**VENDIM**

**Nr. 19 Datë 16.02.2016**

**PËR**

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “DRAGOBIA ENERGY” SH.P.K NË  
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2 gërma “ç” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “f”; 5, pika 1 gërma “f”; 13; 14 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 16.02.2016, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k mbi liçensimin në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike si dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

**Konstatohet se:**

Aplikimi i shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” “c”) është plotësuar në mënyre korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9 pika 4/9 gërmat “a”, ”b” dhe “c”), janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të liçensojë shoqërinë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5 – vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.